



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P. 43/2019**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.01.2019 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Modifikimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit me Nr.REF-96956-12-05-2018 me objekt: “*Sherbimi i lavaxterisë*”, me fond limit 4.614.480 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 24.12.2018 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Spitalit Rajonal Berat.

**Ankimues:**

“Mimoza Deliu” p.f  
L. 5, Rruga e Punëtorëve, Nd. 2 kateshë, Nr. 5465, Kati 1, Kavajë.

**Autoriteti Kontraktor**

Drejtoria e Spitalit Rajonal Berat.  
Lagjia Kushtrim, Berat

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V ë r e n:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

#### *Rrethanat e çështjes.*

II.1. Në datën 07.12.2018 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit me Nr.REF-96956-12-05-2018 me objekt: “*Sherbimi i lavyerisë*”, me fond limit 4.614.480 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 24.12.2018 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Spitalit Rajonal Berat.

II.2. Në datën 12.12.2018, operatori ekonomik “Mimoza Deliu” p.f ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit me argumentat si vijon:

*“Në dokumentat e tenderit të publikuar konstatojmë se disa nga kriteret e vecanta për kualifikim, janë në kundërshtim me LPP dhe RRPP, si dhe nuk janë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.*

*Më konkretisht:*

1. Në shtojcën 7, Pjesa 2 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, pika 2.3.3 është kërkuar që: “Operatori ekonomik duhet të ketë një Ing.Kimist (kontratë pune e noteruar, diplomë, CV, librezë).”

*Për autoritetin kontraktor është mëse e mjaftueshme që operatari fitues në momentin e lidhjes së kontratës, në rast se shpallet fitues, të ketë në listpagesë të paktën një Ing.Kimist, kjo pasi nuk mund të diskriminojë subjektet pjesëmarrëse të cilët nuk e kanë patur të nevojshme praninë e një pozicioni të tillë në subjektin e tyre.*

*Në konkluzion:*

*Kërkojmë që të modifikohet në dokumentat e tenderit dhe kjo kërkesë dhe të bëhet:*

*“Operatori ekonomik të ketë një Ing.Kimist në momentin e nënshkrimit të kontratës nëse shpallet fitues (kontratë pune ose shërbimi, diplomë, CV, librezë).*

2. *Sa i përket certifikatave sipas konformitetit me standardet europiane nuk janë kërkuar fare nga autoriteti kontraktor edhe pse janë pjesë shumë e rëndësishme e mbarëvajtjes së punës dhe kërkojmë shtimin e tyre si pjesë e kriterëve për kualifikim.*

*Konkretisht gjykojmë se është e domosdoshme që OE të jetë i certifikuar dhe të disponojë certifikatat e vlefshme të mëposhtme:*

- *Certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të kualitetit të shoqërisë sipas konformitetit me standardet europiane ISO 9001:2015.*
- *Certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të ambientit sipas konformitetit me standardet europiane ISO 14001:2015.*
- *Certifikatë që vërteton kontrollin mikrobiologjik të cilësisë së tekstileve të trajtuara në lavaxteri, sipas konformitetit me standardin europian UNI EN 14065:2004.*

*Në konkluzion:*

*Kërkojmë që të shtohen në Dokumentat e Tenderit kjo kërkesë dhe të bëhet:*

- *Certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të kualitetit të shoqërisë sipas konformitetit me standardet europiane ISO 9001:2015.*
- *Certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të ambientit sipas konformitetit me standardet europiane ISO 14001:2015.*
- *Certifikatë që vërteton kontrollin mikrobiologjik të cilësisë së tekstileve të trajtuara në lavaxteri, sipas konformitetit me standardin europian UNI EN 14065:2004.*

3. *Gjithashtu makineritë larëse duhet të jenë të dedikuara për përpunimin e materialeve spitalore. Nuk duhet të jenë thjesht profesionale (industriale), por barriera sanitare me dy porta, porta hyrëse për materialin e papastër dhe porta dalëse për materialin e pastër, me qëllim që materialet e lara të mos kenë kontakt me ato të palarat në mënyrë që të kemi një proces sa më pak infektiv.”*

II.3. Njëpërmjet shkresës nr. 1907/1 prot., datë 13.12.2018 me objekt “Kthim përgjigje” të autoritetit kontraktor, operatori ekonomik “Mimoza Deliu” shpk, është vënë në dijeni në lidhje me trajtimin e ankesës së paraqitur prej tij si vijon:

*“Në lidhje me ankesën tuaj, protokolluar tek ne me nr. 1907 prot., datë 12.12.2018, ju bëjmë me dije si vijon:*

*Në lidhje me kërkesën tuaj të parë për ndryshimin e kriterit të shtojcës 7, pjesa 2 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, pika 2.3.3., ku është kërkuar që “operatorët ekonomikë të kenë një Ing.Kimist (kontratë pune e noteruar, diploma, CV, librezë), AK për të qënë i qartë kriteri i kërkuar që do të cojë në mbarëvajtje e shërbimit, do të riformulojë në DST këtë kriter si më poshtë:*

*“Operatori ekonomik, në formularët E-Sig 025a për periudhën janar – tetor 2018, të ketë të përfshirë një Ing.Kimist, shoqëruar me kontratë pune të noteruar, diploma, CV, librezë).*

*Në lidhje me kërkesën tuaj të dytë për kërkimin e certifikatave sipas konformitetit me standardet europiane, AK gjykon të mos ta marrë parasysh këtë kërkesë për arsye të moskufizimit të numrit të operatorëve ekonomikë për pjesëmarrje në këtë procedurë dhe duke arsyetuar që kriteret e tjera të kërkuara nga AK garantojnë mbarëvajtjen e punës për kryerjen e këtij shërbimi.”*

II.4. Në datën 21.12.2018, pala ankimuese operatori ekonomik “Mimoza Deliu” p.f, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke pretenduar si vijon:

1. Në shtojcën 7, Pjesa 2 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, pika 2.3.3 është kërkuar që: “Operatori ekonomik duhet të ketë një Ing.Kimist (kontratë pune e noteruar, diplomë, CV, librezë).”

*Për autoritetin kontraktor është mëse e mjaftueshme që operatori fitues, në momentin e lidhjes së kontratës, në rast se shpallet fitues, të ketë në listpagesë të paktën një Ing.Kimist, kjo pasi nuk mund të diskriminojë subjektet pjesëmarrëse, të cilët nuk e kanë patur të nevojshme praninë e një pozicioni të tillë në subjektin e tyre me kontratë pune por sipas nevojës mund të kenë aplikuar forma të tjera kontraktimi.*

*Në rastin konkret kërkesa që OE të kenë patur të punësuar në listpagesa gjatë të gjithë periudhës janar-tetor 2018 një inxhinier kimist, është një kriter që nuk i shërben qëllimit për realizimin me sukses të kontratës, por krijon efektin e kufizimit për pjesëmarrjen e gjerë të operatorëve ekonomikë. Ajo që është e rëndësishme për AK është që OE të ketë në dispozicion për zbatimin e kontratës një inxhinier kimist ose ekuivalent dhe kjo mund të realizohet duke u provuar një marrëdhënie e qëndrueshme e OE me inxhinierin kimist qoftë në formën e kontratës së punës ashtu edhe të kontratës së shërbimit për një periudhë të arsyeshme, dhe jo domosdoshmërisht përgjatë të gjithë periudhës janar-tetor 2018. Mund të ndodhë që OE të ketë pasur në periudha të ndryshme, të punësuar ose të angazhuar me kontratë shërbimi inxhinier kimist ose mjedisi të ndryshëm, por e rëndësishme për AK është që OE, në momentin e lidhjes eventuale të kontratës, të ketë një inxhinier të tillë, pavarësisht nga historiku dhe natyra e kontraktimit të një inxhinieri të tillë me OE.*

*Autoriteti kontraktor duhet të lejojë dhe të përcaktojë edhe alternative të tjera për përmbushjen e kapacitetit lidhur me personelin kryesor të nevojshëm për të zbatuar kontratën sic janë kontratat e shërbimit etj., duke marrë parasysh që punonjësit mund të kontraktohen për procedurën e prokurimit në fjalë nga profesionistët e nevojshëm për kryerjen e shërbimeve nga momenti i hapjes së procedurës deri në përfundimin e saj.*

*Gjithashtu edhe kërkesa që kontrata të jetë në formën e kontratës noteriale është e ekzagjeruar dhe pa mbështetje ligjore, pasi ligji kërkon që këto kontrata të jenë me shkrim mes palëve, por nuk parashikon që forma e kontratës së punës apo shërbimit të jetë noteriale.*

*AK në përgjigje të kundërshtimit tonë, nuk e ka pranuar atë, por thjesht ka saktësuar që: “operatori ekonomik në formularët E-Sig 025a për periudhën janar – tetor 2018 të ketë të përfshirë një Ing.Kimist, shoqëruar me kontratë pune të noterizuar, diploma, CV, Libreze).*

*Mbetet për tu theksuar fakti që AK i qëndron kërkesës që Ing.Kimist duhet të jetë i punësuar për një periudhë të përcaktuar, duke bërë të mundur diskriminimin për ato subjekte të cilat nuk e kanë patur të nevojshëm një pozicion të tillë për periudha të caktuara, prandaj dhe i sugjeruam AK që subjekti fitues të ketë të angazhuar me kontratë pune ose shërbimi një profesionist të tillë, në momentin e nënshkrimit të kontratës.*

*Në konkluzion:*

*Kërkojmë që të modifikohet në dokumentat e tenderit kjo kërkesë dhe të bëhet:*

*“Operatori ekonomik të ketë një Ing.Kimist në momentin e nënshkrimit të kontratës nëse shpallet fitues, ose alternativisht të paktën para datës së paraqitjes së ofertave të njoftuar nga AK në njoftimin fillestar të kontratës (kontratë pune ose shërbimi, diplomë, CV, librezë).”*

- 2. Certifikatat e cilësisë konform me standardet europiane nuk janë kërkuar fare nga autoriteti kontraktor edhe pse janë pjesë shumë e rëndësishme e mbarëvajtjes së punës dhe kërkojmë shtimin e tyre si pjesë e kriterëve për kualifikim.*

*Konkretisht gjykojmë se është e domosdoshme që OE të jetë i certifikuar dhe të disponojë certifikatat e vlefshme të mëposhtme:*

- Certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të kualitetit të shoqërisë sipas konformitetit me standardet europiane ISO 9001:2015.*
- Certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të ambientit sipas konformitetit me standardet europiane ISO 14001:2015.*
- Certifikatë që vërteton kontrollin mikrobiologjik të cilësisë së tekstileve të trajtuara në lavanteri, sipas konformitetit me standardin europian UNI EN 14065:2004.*

*Në konkluzion:*

*Kërkojmë që të shtohen në Dokumentat e Tenderit kjo kërkesë dhe të bëhet:*

- Certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të kualitetit të shoqërisë sipas konformitetit me standardet europiane ISO 9001:2015.*
- Certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të ambientit sipas konformitetit me standardet europiane ISO 14001:2015.*
- Certifikatë që vërteton kontrollin mikrobiologjik të cilësisë së tekstileve të trajtuara në lavanteri, sipas konformitetit me standardin europian UNI EN 14065:2004.*

*AK në përgjigje të kundërshtimit tonë ka pranuar që: “AK gjykon të mos marrë parasysh këtë kërkesë për arsye të moskufizimit të numrit të operatorëve ekonomikë për pjesëmarrje në këtë procedurë dhe duke arsyetuar që kriteret e tjera, të kërkuara nga AK, garantojnë mbarëvajtjen e punës për kryerjen e këtij shërbimi.*

*Në fakt, pajisja e subjekteve me këto certifikata është kushti minimal që duhet plotësuar nga subjektet, të cilat marrin përsipër për të ofruar punë kaq delikate sic është shërbimi i lavanterisë për spitale. Nuk është një kriter aspak diskriminues, pasi kjo është një normë minimale që duhet plotësuar nga të gjithë subjektet që ofrojnë këtë shërbim.*

*AK nuk mund të përdorë 2 standarde në vendosjen e kriterëve kur kujtojmë që, në kriterin e pare, ka bërë një diskriminim, duke përcaktuar kufirin e kohës se kur duhet të jetë i punësuar një pozicion i caktuar dhe në kriterin e radhës quan diskriminim për subjektet e tjera të paturit kërkesat minimale për certifikatat e cilësisë.*

- 3. Gjithashtu makineritë larëse duhet të jenë të dedikuara për përpunimin e materialeve spitalore. Nuk duhet të jenë thjesht profesionale (industriale), por barriera sanitare me dy porta, porta hyrëse për materialin e papastër dhe porta dalëse për materialin e pastër, me qëllim që materialet e lara të mos kenë kontakt me ato të palarat në mënyrë që të kemi një proces sa më pak infektiv.*

*AK nuk ka dhënë asnjë përgjigje për këtë kërkesë.*

*Kërkojmë që:*

*Ky kriter të shtohet, pasi në materialin e lavanterisë së spitalit kemi të bëjmë me material të butë i cili mund të jetë i infektuar dhe masa minimale që kërkohet për trajtimin e këtij materiali është përdorimi i*



*lavatriceve me barriera sanitare (me 2 porta) e cila bën të mundur që materiali i butë, pasi të përfundojë procesin e larjes, mos të ketë kontakt me pjesën hyrëse të materialeve të buta të kontaminuara.”*

II.5. Me shkresën me nr. 1993 prot, datë 31.12.2018, protokolluar me tonën me nr. 1932/2 prot, datë 04.01.2019, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Mimoza Deliu” p.f se: “Në shtojcën 7, Pjesa 2 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, pika 2.3.3 është kërkuar që: “Operatori ekonomik duhet të ketë një Ing.Kimist (kontratë pune e noteruar, diplomë, CV, librezë).” Për autoritetin kontraktor është mëse e mjaftueshme që operatari fitues në momentin e lidhjes së kontratës, në rast se shpallet fitues, të ketë në listpagesë të paktën një Ing.Kimist, kjo pasi nuk mund të diskriminojë subjektet pjesëmarrëse të cilët nuk e kanë patur të nevojshme praninë e një pozicioni të tillë në subjektin e tyre. Në konkluzion: Kërkojmë që të modifikohet në dokumentat e tenderit dhe kjo kërkesë dhe të bëhet: “Operatori ekonomik të ketë një Ing.Kimist në momentin e nënshkrimit të kontratës nëse shpallet fitues (kontratë pune ose shërbimi, diplomë, CV, librezë)”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.3, gërma të dokumentave të tenderit, të publikuara në datën 07.12.2018, nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesave si më poshtë vijon:

*“Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar 10 (dhjete ) punonjes per periudhen janar – Tetor 2018, te vertetuar me:*

- Vertetim nga dega e tatim taksave per numrin e punonjesve te siguruar te shoqeruar me listepagesat(formularet E-sig 025 a) sipas sistemit E-Albania.*
- Operatori ekonomik te kete nje Ing. Kimist(kontrate pune e noteruar, diplom, CV,librezë).”*

Në datën 14.12.2018 autoriteti kontraktor ka publikuar një shtojcë në sistemin elektronik të prokurimeve, duke bërë modifikimin e kriterit të mësipërm si vijon:

#### **ISHTE**

##### **2.3 Për kapacitetin teknik:**

*Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar 10 (dhjete ) punonjes per periudhen janar – Tetor 2018, te vertetuar me:*

- Vertetim nga dega e tatim taksave per numrin e punonjesve te siguruar te shoqeruar me listepagesat(formularet E-sig 025 a) sipas sistemit E-Albania.*

- *Operatori ekonomik te kete nje Ing. Kimist(kontrate pune e noteruar, diplom, CV,librez).*

## **BEHET**

### **2.3 Për kapacitetin teknik:**

*Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar 10 (dhjete ) punonjes per periudhen janar – Tetor 2018 , te vertetuar me:*

- *Vertetim nga dega e tatim taksave per numrin e punonjesve te siguruar te shoqeruar me listepagesat(formularet E-sig 025 a) sipas sistemit E-Albania.*
- *Operatori ekonomik ne listpagesat (formularet E-sig 025 a) sipas sistemit E-Albania per periudhen Janar – Tetor 2018 te kete nje Ing. Kimist(kontrate pune e noteruar, diplom, CV,librez).*

III.1.2. Në nenin 46 pika 1, gërma “b” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “[...] *Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;*

III.1.3. Në nenin 28, pika 5, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose*
- c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.1.4. Neni 1 i LPP parashikon shprehimisht se “*Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik si dhe dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*”

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj

autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Komisioni vlereson se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës. Në rastin konkret e rëndësishme për autoritetin kontraktor, referuar natyrës së kontratës është realizimi i shërbimit në përputhje me specififikimet teknike dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

Sa më sipër cituar, KPP gjykon se në plotësim të synimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të dëshmojnë vijueshmëri të marrëdhënieve të punësimit me inxhinierin e sipërcituar, duke dorëzuar dëshmi se për periudhën e kërkuar kanë patur vijueshmëri të stafit teknik (inxhinier) sipas profilit të sipërcituar, megjithëse këto të fundit mund të jenë të ndryshëm nga inxhinieri që disponon të kontraktuar në momentin e dorëzimit të ofertave. Gjithashtu KPP gjykon se është mëse e mjaftueshme që operatori ekonomik ofertues të ketë në stafin e vet inxhinier kimist me kontratë pune sipas ligjit por njëkohësisht autoriteti kontraktor duhet të lejojë alternativën që operatori ekonomik të kontrakttojë me kontratë noteriale për periudhën e zbatimit të kontratës një inxhinier kimist dhe për këtë të paraqesë diplomë dhe cv sipas përcaktimeve të autoritetit kontraktor në DST, duke mbajtur në konsideratë edhe vijueshmërinë e kapacitetit të periudhës së kërkuar.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.2. Lidhur me pretendimet e ankimuesit se: *“kërkesa që OE të kenë patur të punësuar në listpagesa gjatë të gjithë periudhës janar-tetor 2018 një inxhinier kimist, është një kriter që nuk i shërben qëllimit për realizimin me sukses të kontratës, por krijon efektin e kufizimit për pjesëmarrjen e gjerë të operatorëve ekonomikë. Ajo që është e rëndësishme për AK është që OE të ketë në dispozicion për zbatimin e kontratës një inxhinier kimist ose ekuivalent dhe kjo mund të realizohet duke u provuar një marrëdhënie e qëndrueshme e OE me inxhinierin kimist qoftë në formën e kontratës së punës ashtu edhe të kontratës së shërbimit për një periudhë të arsyeshme, dhe jo domosdoshmërisht përgjatë të gjithë periudhës janar- tetor 2018. Mund të ndodhë që OE të ketë pasur në periudha të ndryshme, të punësuar ose të angazhuar me kontratë shërbimi inxhinier kimist ose mjedisi të ndryshëm, por e rëndësishme për AK është që OE, në momentin e lidhjes eventuale të kontratës, të ketë një inxhinier të tillë, pavarësisht nga historiku dhe natyra e kontraktimit të një inxhinieri të tillë me OE. Autoriteti kontraktor duhet të lejojë dhe të përcaktojë edhe alternative të tjera për përmbushjen e kapacitetit lidhur me personelin kryesor të nevojshëm për të zbatuar kontratën sic janë kontratat e shërbimit etj., duke marrë parasysh që punonjësit mund të kontraktohen për procedurën e prokurimit në fjalë nga profesionistët e nevojshëm për kryerjen e shërbimeve nga momenti i hapjes së procedurës deri në përfundimin e saj. Gjithashtu edhe kërkesa që kontrata të jetë në formën e kontratës noteriale është e ekzagjeruar dhe pa mbështetje ligjore, pasi ligji kërkon që këto kontrata të jenë me shkrim mes palëve, por nuk parashikon që forma e kontratës së punës apo shërbimit të jetë noteriale”,* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në nenin 63, pika 1, 1.1 dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht se: *“Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”* Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data



e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni.”. Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: “Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”

III.2.2. Referuar *lex specialis*, ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik të ndryshuar” *strictu senso* parashikohet se ankimi administrativ pranë autoritetit kontraktor dorëzohet me shkrim brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Në rastin konkret KPP konstaton se, ankimuesi ka marrë dijeni për kërkesat e autoritetit kontraktor nga publikimi i dokumentave të tenderit në SPE në datën 07.12.2018 si dhe nga modifikimi i tyre në datën 14.12.2018. Referuar materialeve të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrative, KPP konstaton se operatori ekonomik ankimues në lidhje me pretendimet e mësipërme shtesë, nuk ka ezuaruar ankim administrativ pranë autoritetit kontraktor në respekt të nenit 63 të LPP-së, si një shkallë e parë e ankimit administrative, por ka parashtruar pretendime vetëm pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ankesa e dorëzuar nga operatorit ekonomik “Mimoza Deliu” p.f pranë K.P.P. në lidhje me pretendimet e mësipërme, nuk ka respektuar shkallët e ankimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “elementet e domosdoshëm të ankesës”, referuar nenit 26, pikës 3, shkronja “a”, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ndaj dhe përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të mosrespektimit të afateve të ankimit. Komisioni Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i ankimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik “Mimoza Deliu” p.f nuk merren në shqyrtim.

III.3. Lidhur me pretendimet e ankimuesit të parashtruara në pikën 2 dhe 3 të ankesës sipas të cilave: “(2) Sa i përket certifikatave sipas konformitetit me standardet europiane nuk janë kërkuar fare nga autoriteti kontraktor edhe pse janë pjesë shumë e rëndësishme e mbarëvajtjes së punës dhe kërkojmë shtimin e tyre si pjesë e kriterëve për kualifikim” dhe “(3) Gjithashtu makineritë larëse duhet të jenë të dedikuara për përpunimin e materialeve spitalore. Nuk duhet të jenë thjesht profesionale (industriale), por barriera sanitare me dy porta, porta hyrëse për materialin e papastër dhe porta dalëse për materialin e pastër, me qëllim që materialet e lara të mos kenë kontakt me ato të palarat në mënyrë që të kemi një proces sa

*më pak infektiv*”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ka një ndarje të qartë mes rolit të tij të paraparë nga ligji si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike (neni 19/1 e vijues i LPP-së) dhe autoriteteve kontraktore si organ përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit (neni 12 i LPP-së) dhe njëherazi përgjegjës për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik. Në nenin 63 pika 1.1. të LPP-së, parashikohet se “*Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik.*” KPP gjykon se, që të justifikohet ligjërisht kërkimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar duhet që të bëhet vetëm prej atij që i përket, sipas ligjit, e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti dhe vetëm kundër atij që me faktin ose me veprën e tij mohon ose shkel të drejtën e kërkuesin (legjitimimi pasiv), duke justifikuar me këtë fakt ose veprim ndërhyrjen e organit administrativ për të ndaluar ose për të zhdukur dëmin e rrjedhur nga ky fakt, ose veprimeve (*legitimation ad causam*), pra operatori ekonomik ankimes duhet të provojë se interesi i tij i ligjshëm është cënuar nga vendime dhe veprime konkrete (reale) të autoritetit kontraktor. Në rastin konkret, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar mekanizmat ligjorë për kundërshtimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit pranë këtij të fundit, duke dhënë garanci të plota operatorëve ekonomikë ankimes se procedurave për fitimin e kontratave publike, do ti nënshtrohet kushteve specifike (kriterëve të veçanta të kualifikimit), të cilat duhet të përmbushin parakushtin *sine qua non* të parashikuar nga neni 46 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, të ndryshuar, duke qenë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese. Në rastin konkret, KPP gjykon se njësia e prokurimit pranë autoritetit kontraktor ka parashikuar kriteret minimale kualifikuese, të gjykuar të nevojshëm për vërtetimin e plotësisht të kapacitetit teknik të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi. Kuadri ligjor në fuqi, ka paraparë pozitën juridike të Komisionit të Prokurimit Publik, si organ i shqyrtimit të ankesave kundër vendimeve të shprehura me akte administrative (dokumentet e procedurës së prokurimit) duke i dhënë të drejtën ligjore të shprehet mbi kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike në rast se këto të fundit janë hartuar në përputhje me ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, të ndryshuar dhe kuadrin ligjor në fuqi që rregullon kontratën objekt prokurimi. Kompetenca e mësipërme është shprehur në disa drejtime në ligjin për prokurimin publik në fuqi, ku nën nenin 63 pika 4 gërma “b” të *lex specialis* parashikohet se ndër kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik janë ato të *anulimit, plotësisht ose pjesërisht, një veprimi ose vendimi të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj.* Në rastin konkret, KPP gjykon se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimes nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se kriteret kualifikuese janë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, apo në rast se specifikimet teknik janë hartuar në formën e kërkuar nga ligji), por mbi shtimin e kriterëve kualifikuese në një procedurë prokurimi.

Sa më sipër, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar se është në të drejtën e plotë të autoritetit kontraktor të parashikojë kriteret minimale kualifikuese në një procedurë prokurimi dhe në rast se këto të fundit, nuk janë në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi, jepet garancia procedurale e paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Për sa kohë që kriteret e mësipërme nuk janë kërkuar do të thotë që autoriteti kontraktor nuk i ka parë të nevojshëm për realizimin e shërbimit dhe KPP në asnjë

rast nuk mund të marrë kompetencat e autoritetit kontraktor ( njësisë së prokurimit) të shtojë kriteret e tjera kualifikuese për marrjen pjesë në procedurat e prokurimit publik.

III.4. Gjithashtu sipas informacionit të autoritetit kontraktor si dhe nga verifikimet e kryera nga KPP në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, rezulton se në datën 24.12.2018 autoriteti kontraktor ka vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit, pra me hapjen e ofertave.

III.4.1. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje se Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, ( *Neni 9 i K.pr. Administrative*). Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në neni 2 të tij janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Nenin 63, pika 1, dhe 1.1. dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “*Për prokurimin publik*” është parashikuar: “*Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.*” “*Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik.*”. Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: “*Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.*”

III.4.2. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në neni 2 të tij janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

III.4.3. KPP konstaton, se autoriteti kontraktor ka vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt ankimi, duke pranuar ofertat nga ana e operatorëve ekonomikë, gjatë periudhës kohore ku operatorëve ekonomikë, të cilët kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, i lind e drejta e ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik për dokumentat e tenderit. Sa më sipër, KPP gjykon se në respekt të nenit 64 pika 3 gërma ‘ç’ të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*” të ndryshuar, në të cilin parashikohet se “*Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë: a) ç) të urdhërojë anulimin e procedurave për shpalljen e kontratës fituese.*”, për shkak të shkeljeve të mësipërme procedurale autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Mimoza Deliu” p.f për procedurën e prokurimit me Nr.REF-96956-12-05-2018 me objekt: “Sherbimi i lavyerise”, me fond limit 4.614.480 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 24.12.2018 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Spitalit Rajonal Berat.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Me rishpalljen e procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentat e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të verë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Mimoza Deliu” p.f.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**Nr. 1932 Protokoli**

**Datë 21.12.2018**

### KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**